

SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Udhëheqës i Divizionit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit
Niveli i gradës:	P03
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti/Divizioni:	Divizioni për Mbikëqyrjen e Sistemeve të TI të Institucioneve Financiare
Raporton tek:	Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Përgjegjës për realizimin e ekzaminimeve të fushës së sistemeve të informacionit dhe sigurisë kibernetike për sektorin financiar;
- Hartimi i planit të ekzaminimeve bazuar në vlerësimin e riskut, si dhe ndarjen e duhur të kapaciteteve të nevojshme për realizimin e tyre;
- Vlerëson përshtatshmërinë dhe adekuatshmërinë e sistemeve të informacionit dhe sigurisë kibernetike, duke përfshirë edhe qendrueshmërinë e tyre, si dhe vlerësimet e rrezikut dhe testimet e tjera;
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive të mbikëqyrjes për të siguruar që sistemet e informacionit në sektorin financiar përmbushin standardet rregullatore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Këshillimi i drejtuesve të lartë lidhur me përparimet e reja teknologjike dhe ndikimin e tyre në mbikëqyrjen rregullatorë;
- Hartimi i dokumenteve strategjike për qeverisjen e sistemeve të informacionit, sigurinë kibernetike dhe qendrueshmërinë operationale në sektorin financiar;
- Mbikëqyrja e përputhshmërisë së institucioneve financiare me rregulloret për menaxhimin e rrezikut të TI-së, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave;
- Analizimi i ndikimit të teknologjive të reja dhe digjitalizimit në stabilitetin financiar dhe përcaktimi i qasjeve mbikëqyrëse për të minimizuar rreziqet;
- Analizimi i përputhshmërisë së sistemeve të informacionit me rregulloret ndërkombëtare për sigurinë dhe integritetin e të dhënave;
- Hartimi dhe zbatimi i kuadrove rregullatore për menaxhimin e incidenteve kibernetike, reagimin ndaj kërcënimeve dhe planifikimin e qendrueshmërisë operationale;
- Bashkëpunimi me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe përgjigjen ndaj incidenteve kibernetike;

- Udhëheqja e grupeve të punës për realizimin e ekzaminimeve dhe përgatitjen e dokumenteve rregullatore dhe udhëzimeve teknike për industrinë financiare;
- Udhëheqë dhe menaxhon personelin përgjegjës për mbikëqyrjen e sistemeve të informacionit, duke siguruar delegimin efektiv të detyrave, monitorimin e performancës dhe përputhshmërinë me objektivat e divizionit.
- Realizon shpërndarjen e punës, optimizimin e burimeve dhe siguron një mbikëqyrje cilësore;
- Monitorimi i zhvillimeve teknologjike dhe propozimi i ndryshimeve në politikat rregullatore për të adresuar inovacionet digjitale;
- Përgatitja e rekomandimeve për të përmirësuar metodologjinë e ekzaminimit dhe mjeteve mbikëqyrëse për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së Sistemeve të Informacionit;
- Bashkëpunimi me autoritetet rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizatat financiare për të harmonizuar qasjet rregullatore dhe për të forcuar mbikëqyrjen e sigurisë kibernetike;
- Pjesëmarrja aktive në komitete ndërkombëtare dhe grupe pune për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të promovuar standardet globale të sigurisë dhe qeverisjes së TI-së;
- Organizimi i seminareve, punëtorive dhe forumeve të industrisë për të ndarë njohuritë dhe për të përmirësuar ndërgjegjësimin për rreziqet kibernetike dhe teknologjike;
- Udhëheqja e nismave për zhvillimin e aftësive teknike dhe njohurive të ekipeve mbikëqyrëse në IT, sigurinë kibernetike dhe teknologjinë rregullatore;
- Krijimi i programeve të trajnimit dhe certifikimit për ekipet e mbikëqyrjes për të përmirësuar kapacitetet në analizën e rrezikut të IT-së dhe qeverisjen e sigurisë;
- Monitorimi i përparimeve teknologjike dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në sektorin financiar, përfshirë AI, Blockchain, dhe Cloud Computing;
- Zhvillimi i strategjive rregullatore për të mbështetur inovacionin dhe adoptimin e teknologjive të reja në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme;

Edukimi:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikës apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë e njësisë organizative në linkun: <https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare/departamentet-e-mbikqyrjes-financiare/>
- Certifikime profesionale: Siguria e Informacionit dhe Qeverisja e IT-se: CISA (Certified Information Systems Auditor); CISM (Certified Information Security Manager); CISSP (Certified Information Systems Security Professional) përparësi;

Përvoja e punës:

- Të ketë së paku gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, prej tyre së paku tre (3) vite përvojë menaxheriale, në sektorin financiar ose përvojë në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në këtë shpallje si dhe uebfaqen e BQK-së në linkun: <https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare/departamentet-e-mbikqyrjes-financiare/>

Njohuritë e kërkuara:

- Preferohet të ketë certifikime në fushën e përgjegjësive të njësisë organizative dhe sektorit financiar;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe prezantimi;

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes;
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë **së paku gjashtë (6) vite** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon **së paku gjashtë (6) vite** përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **07 korrik 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.